




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Procesverbal i takimit të tretë publik buxhetor për buxhetin e vitit 2027, të mbajtur në Bashkësinë Lokale të Turiqecit

Data: 21.08.2026

Ora: 13:30

Vendi: SHFMU “Abedin Rexha” Turiqec

Të pranishëm: Nënkrjetari i Komunës z. Fadil Nura, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet e Financa z. Behxhet Maliqi, Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, z. Arbnor Çitaku, Drejtoresha e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Ndërmarrësisë, Inovacionit dhe Turizmit znj. Besarta Meha Ademi, Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport znj. Kosovare Ahmeti si dhe qytetarët nga lista pjesëmarrëse e bashkangjitur më poshtë.

Nënkrjetari i Komunës z. Fadil Nura: Fjala hyrëse/përshëndetëse – hapja e takimit.

Këto takime janë dëgjime buxhetore publike që i kemi të obliguara edhe me ligj. Për të qenë i sinqertë ne pothuajse 90% të kërkesave dhe nevojave veçse i dimë, si në Burojë, Turiqec e me radhë. Buxhetin e kemi të kufizuar jo vetëm ne, kontratat kolektive e kanë prishë strukturën buxhetore. Nuk kemi bashkëpunim me nivelin qendror madje kemi edhe bllokada.

Sidoqoftë sot jemi këtu, në takimin e tretë të dëgjimit buxhetor për planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm 2027 dhe parashikimet për dy vitet e tjera 2028-2029. Jemi këtu me iu dëgju për kërkesat dhe nevojat, ato të cilat ju i keni me shumë prioritet.

Fillimisht ia kaloj fjalën Drejtorit të Financave, pastaj kalojmë tek ju.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet e Financa z. Behxhet Maliqi: Fjala hyrëse. Se bashku me Bordin e Drejtorëve, Kryetarin dhe Nënkrjetarin jemi munduar maksimalisht që të bëjmë një planifikim buxhetor të përgjegjshëm, brenda mundësive financiare që i kem. Buxheti për vitin 2027 është 20 milion e 814 e 790 euro. I kemi destinuar sipas këtyre kategorive: për paga dhe shpenzime 12 milion e 472 mijë e 426 euro janë planifiku nga ne për vitin 2027. Janë 3 milion e 306 mijë e 675 euro mallrat dhe shërbimet. 326 mijë e 700 euro pagesa për rrymë, për mbeturina për obligime të shërbimeve komunale. 1 milion e 10 mijë euro janë për subvencione: subvencionimi në bujqësi, në shëndetësi, bursa. Për projekte kapitale janë planifiku 3 milion e 918

mijë e 810 euro. Ky është totali i buxhetit që ne e kemi dorëzuar në qeveri për aprovim dhe qeveria e ka kthyer Qarkorën e Dytë ku ka ndodhë vetëm një ndryshim. Është ulë për 774 mijë e 671 euro në investimet kapitale duke i kaluar në katgorinë e pagave, prej 3 milion e 918 mijë e 810 euro në 3 milion e 144 mijë e 139 euro dhe janë rritë pagat për këtë shumë, kategoria e pagave është 13 milion e 27 mijë e 275 euro.

Kjo është struktura buxhetore për vitin 2027. Jam i hapur për çfarëdo pyetje apo sqarimi sa i përket pjesës së planifikimit buxhetor.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Me mua së bashku është: Drejtori i Financave, Drejtori i Urbanizmit, Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoresha e Kulturës, kemi dëshirë t'i degjojmë kërkesat tuaja, ato të cilat ju keni me shumë nevojë dhe i keni me më prioritet. Fjala është e juaja.

Fadil Beqa – Banor i fshatit Burojë: Fjala hyrëse. Kërkesa jonë është që projektet që i keni bo me funksionu me shumë, meqenëse mundesitë për projekte të reja nuk janë. Shërbimi i mbeturinave nuk është me rregull, vetëm dy herë ose tri herë në muaj, po grumbullohen mbeturinat po kundërmojnë. Shërbimi tjetër është edhe ndriçimi publik, një projekt që në Burojë është kryer mirëpo shumë drita prej tyre pra, 70% nuk po funksionojnë. Ujësjiellësi gjithashtu, është sistemi, mirëpo po mungon furnizimi me ujë sidomos gjatë verës në disa lagje, sepse gjatë vjeshtës gjendja është shumë më mirë.

E rëndësishme është edhe rruga Martirët e Burojës është një pjesë shumë e dëmtuar, veturat po dëmtohen, ndoshta është diku 500m. Ka nevojë për mbyllje të atyre gropave.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Sa i përket shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, ne e kemi planifikuar nga viti i kaluar, një gjysëm plani me e bo si Vushtrria që Unitetin me e fuzionu në kompaninë Eko-natyrë, që kompetencat me i pasë Komuna më afër. Uniteti e ka një bord në Mitrovicë, janë vendime që i marin bashkë tri Komuna, ata i përgjigjen Komunave, mirëpo kan bukur shumë telashe në menaxhim dhe në paisje.

Ne kemi arritë që mbulimin me kontejner 100% me ba, kemi arritë 2 kamiona të ri edhe pse janë të pamjaftueshëm, me gizin gjerman me furnizu, mirëpo terreni është zgjeruar sidomos edhe në zonat rurale, shpenzimet janë më të mëdha. Ka nevojë që shërbimi me u përmirësu, nuk e mendoj, që me qenë në nivel të duhur, që të paktën të ofrohet një herë në javë. Këtë kërkesë do ta adresoj dhe do bëjme gjithçka që ta përmirësojmë si shërbim.

Sa i përket ndriçimit, nuk është problemi i poçave, sepse ata janë të testuar, me një performancë të caktuar ashtu siç është kërkuar, mirëpo problemi është deri të stabilizohen siguresat për kyçje dhe shkëqje, ndodhë që ato shpesh të lëvizin, e njëjta ka ndodhur në Polac por është rregulluar si problem.

Pjesën e rrugës Martirët e Burojës njëherë e kemi rinovuar por nuk është rinovuar mirë, drejtori e ka parasysh dhe e marim përsipër dhe do e rregullojmë sepse nuk kushton shumë.

Pajazit Thaçi - Banor i fshatit Burojë: Fjala hyrëse. Të ne, në lagjen tonë nuk kemi ndriçim, edhe diku 5 rrugë diku kah 50-60m pa asfaltu, ujësjiellësi, gypat janë mirëpo prapë nuk ka ujë, mbeturinat, shërbimi po bëhët kryesisht çdo dy javë.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Sa i përket ujit, e di që në Burojë, pjesa më e madhe e gypave është kryer, por problemi është i furnizimit me ujë nga Mitrovica. Pa u kry Projekti i Brusit

nuk ka ujë të mjaftueshëm. Në Burojë, jemi munduar edhe me hapje të bunarëve sepse është fshat që ka probleme me ujë, por problemi mbetet të furnizimi nga Mitrovica.

Degëzimet e rrugëve i kemi filluar, por na kanë mbetur në gjysmë, në projekt i kemi të kontraktuar, mirëpo pare nuk kemi. Kontrata Kolektive na ka goditë, diku 5 milion na i kanë mar për 3 vite, që i ka prishë planet tona për me i realizu sipas planeve që i kemi pasë.

Halil Muja – Banor i fshatit Vajnikë: Fjala hyrëse. Një kërkesë për fshatin Vajnikë, për ndriçim, gjithashtu edhe për ujë, të shtëpia ime nuk kemi ujë gjithë verën, të paktën një herë në javë me pasë ujë.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Për ujë, ka mungesë të furnizimit me ujë, as në qytet nuk kemi ujë të mjaftueshëm, ky është realiteti. Furnizimin me ujë e ka përgjegjësi ujësjellësi, kompani regjionale jo komunale. Projektin e ndriçimit kur e kemi filluar, e kemi filluar në Bashkësi Lokale, buxhetin për këto projekte na e kanë marrë për shkak të kontratës kolektive, është përfunduar në disa fshatra, ka me vazhu edhe në të gjitha fshatrat tjera, në mundësinë e parë që do ta kemi.

Sami Ibrahim – Banor i fshatit Turigec: Fjala hyrëse. U përmenden ujësjellësi, kanalizimi, ndriçimi, degëzimet, të gjitha këto në Bashkësinë Lokale të Turigecit kanë nevojë për renovim. Kemi nevojë që në Bashkësinë Lokale me bo një çerdhe.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: E kemi bërë një kërkesë që në kuadër të shkollave ekzistuese në bashkësitë lokale të bëhen anekse për çerdhe. Ne duhet t'i kemi disa të dhëna, sa fëmijë janë, sepse është një formulë për këtë çështje, mirëpo ne e evidentojmë së çka mundemi me bo.

Haki Ramadani – Banor i fshatit Burojë: Kërkesa ime është për çështjen e shërbimeve të mbeturinave, nëse mundeni pak më shumë presion më i'u bo, sepse po paraqet problem.

Ndërsa për ujë, ne jemi disa lagje që nuk kemi ujë asnjëherë, janë lagja Thaçi, lagja të mahalla e Xhamisë, janë lagja të Ukë Hot, nuk kemi ujë as verës e as dimrit. Gjatë dimrit po rritet edhe rreziku sepse ne e bartim ujin me cisterna dhe po rritet rreziku në rrugë për shkak të borës. Gjithashtu, sipas mundësive i kemi edhe disa rrugica, në disa lagje.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: E di situatën qysh është, gjatë dimrit duhet patjetër me gjet zgjidhje, por edhe për projektet tjera do të vazhdojmë, Komuna është për këto probleme.

Nëse nuk ka dikush tjetër diçka, këtu po e mbylli takimin. Falemiderit shumë për pjesëmarrje.

Procesmbajtëse:

Besjana Thaçi



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin e tretë buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2027 i mbajtur në Bashkësinë Lokale të Turiqecit

Data, vendi dhe ora: E premte, 21 Gusht 2026 – SHFMU “Abedin Rexha”, Turiqec, 13:30

Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nr. telefonit	Nënshkrimi
1	SAMI IBRAHIMI	TURIQEC	044-195-04	Moro
2	HAKI RAMADANI	BURDË	043-571-210	Trigo
3			043-550-1038	
4	Pajazit Gaxi	Burdë	044-195-23	Prerit
5	Fadil Bupa	Burdë	049/858-54	Fadila
6	Haki Shabani	Turiqec	044/654-32	Habani
7	Hani Dagec	VOJMI		
8	Shafet	Hajduti Bld		Shafet
9	Metyza Thaqi	Burdë	043-572-40	Metyza
10	WASER THAQI	BURDË	044-957-132	W. Thaqi
11	DONART THAQI	BURDË	043-888-01	Donart
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				

Fotot e takimit të tretë publik buxhetor për buxhetin e vitit 2027, të mbajtur në Bashkësinë Lokale të Turiqecit

